VENDIM
Nr.918, datë 28.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHËN 1 JANAR-15 QERSHOR 2012 DHE 15 SHTATOR-31 DHJETOR 2012, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2011-2012 dhe 2012-2013, për periudhën 1 janar-15 qershor 2012 dhe për periudhën 15 shtator-31 dhjetor 2012, të jetë 1 300 (një mijë e treqind) veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepet sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2012, në shumën 39 078 000 (tridhjetë e nëntë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2012.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha